



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/11 Nr. i faq./Br.str/No.pg 85

Data/Datum/Date 25/02/2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 19 paragrafi 3 pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 10/2019), konform nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 25.2.2026, merr këtë:

### V E N D I M

1. Me këtë vendim, kompanisë “Base Friends L.L.C.” me NUI 812206838 me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Bashkim Bytyqi nga fshati Dejnë, komuna e Rahovecit, **I JEPET** në shfrytëzim afatgjatë deri **20 (njëzet) vjet** prona e paluajtshme e komunës me certifikatë të pronësisë Nr. P-71510033-00772-10 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Gradish, me kulturë kullosë e klasës V, në sipërfaqe prej 2350m<sup>2</sup> (dy mijë e treqind e pesëdhjetë metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja të përgjithshme prej 20000m<sup>2</sup> (njëzet mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
2. Prona e paluajtshme e cekur në pikën 1 të këtij vendimi jepet për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit sipas rekomandimit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me nr. prot. 787, të datës 6.2.2026.
3. Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës fillon të rrjedhë nga data e nënshkrimit të kontratës së përfituesit me Kryetarin e Komunës, ndërsa pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Rahovecit si titullar faktik dhe juridik i pronës.
4. Çmimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të lartcekur do të jetë 258€ (dyqind e pesëdhjetë e tetë euro) në muaj.
5. Obligohet Kryetari i Komunës që me personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të komunës, të lidhë kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
6. Obligohet shfrytëzuesi i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1 të këtij vendimi ta shfrytëzojë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që të mos e humbë vlerën e saj.
7. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërton titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana

e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01-Nr.112/26**  
**Më 25.2.2026**

